



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 36 datë 29.03.2018

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 48, DATË 11.11.2015 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E TIRANA PARKING SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT PUBLIK ME PAGESË” DHE NË VENDIMIN NR. 49, DATË 11.11.2015 “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe nenit 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Në vendimin nr. 48, datë 11.11.2015 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, bëhet kjo shtesë:

a. Në pikën 1, germa “d”, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia si më poshtë:

“Formati standard për vendosjen e gjobës miratohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë”

2. Në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015 “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzona ve të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, bëhen këto ndryshime, si më poshtë:

a. Në Aneksin nr. 2, Zona A dhe B, shtohen rrugët e reja të parashikuar në relacionin bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Tirana Parking për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI



RELACION

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 48, DATË 11.11.2015 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E TIRANA PARKING SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT PUBLIK ME PAGESË” DHE NË VENDIMIN NR. 49, DATË 11.11.2015 “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS”

Me propozim të “Tirana Parking” dhe për efekt administrimi të nënzonave të destinuara për parkim me pagesë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1. shkronja “b” dhe pika 1/1.3, shkronja “a” dhe “b”, neni 64, shkronjat “a” dhe “b” të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” nenit 7, pika 1, shkronja e e pika 10 e po këtij neni dhe nenit 37 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.48, datë 11.11.2015 për “Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.49, datë 11.11.2015 për “Miratimin e Kriteriave të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim” si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës; me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, i propozohet Këshilli Bashkiak:

Bashkia e Tiranës po i kushton një vëmendje të veçantë transportit dhe lëvizjes në qytetin e Tiranës, si një nga prioritetet më të rëndësishme të punës tonë, sipas kërkesave dhe nevojave të qytetarëve dhe qytetit. Për sa më sipër dhe duke patur parasysh problematikat e përditshme që lidhen me parkimin në qytetin e Tiranës, është shfaqur domosdoshmëria e krijimit të një institucioni varësie të specializuar dhe të fokusuar në çështjet e parkimit. Bashkia Tiranë, për këtë, ka krijuar institucionin në varësi të tij, “Tirana Parking”, që është krijuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, Tiranë me nr.48, datë 11.11.2015 për “Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për: “Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”.

Tirana Parking synon të ketë një rol ekzekutiv në lidhje me zbatimin e politikave të parkimit të hartuar nga Bashkia e Tiranës. Detyrat kryesore të këtij institucioni janë:

- I. të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës,
- II. të planifikojë dhe të udhëkojë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e shërbimit e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
- III. të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;

Në zbatim të strategjisë së transportit të qëndrueshëm në qytetin e Tiranës që parashikon sistemin e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve sipas parimit të shpërndarjes së sipërfaqes së rrugëve për çdo perdorues duke i dhënë prioritet mjeteve të shërbimit publik, lëvizjes me bicikleta dhe lëvizjes këmbësorëve. Nga relacioni i korsive të bicikletave u kostatuan se disa nga rrugët e të Vendim të Këshillit Bashkiak, Nr.49, datë 11.11.2015, Tiranë për: “Miratimin e Kriteriave të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim” janë kthyer në korsi bicikletash.

Tirana Parking humbet të drejtën e administrimit të vendparkimeve në një seri rrugësh që aktualisht janë në proces korsie bicikletash si :

- Bulevardi Deshmoret E Kombit (Seg.Blv. Gjergj Fishta – Rr.Myslym Shyri)
- Rruga Dibres (Seg. Qender- Farmacia 10)

Vendparkimet e administruara nga Tirana Parking në rrugët e cituara më poshtë janë parashikuar për tu kthyer në korsi bicikletash në vitin 2018 si :

- Rruga "Ibrahim Rugova" (segmenti "Abdyl Frashri"- Rruga "Lek Dukagjini")
- Rruga "Hoxha Tahsin" (segmenti "Sheshi Avni Rustemi"- Rruga "Bardhyl")
- Rruga "Muhamet Gjollesha" (segmenti "Blv. Gjergj Fishta"- Zogu Zi)
- Rruga "Kavajes" (segmenti "21-shi"- Fabrika e Bukes) *le funksionojnë*
- Rruga "Sulejman Delvina" (segmenti "Bajram Curri"- Rruga "Sheshi Willson") *le funksionojnë*
- Rruga "Abdyl Frashri" (segmenti "Blv.Deshmoret e Kombit"- "Sheshi Willson")
- Rruga "Deshmoret e kater shkurtit" (segmenti "Sheshi Willson"-Dora D'Istria)

Mbasi është bërë analiza e situatës, vlerësimi i nevojave dhe mundësitë për organizimin e parkimit, propozohet shtimi i disa rrugëve të reja në zonën A dhe B të VKB nr.49, datë 11.11.2015 për shqyrtimin dhe miratimin e disa rrugëve.

Rrugët e propozuara për administrim nga Tirana Parking janë :

1. Rruga "Asim Zeneli" (segmenti "Papa Gjon Pali II"- Rruga "Elbasanit")-Zona A
2. Rruga "Ismail Qemali" (segmenti Blv "Deshmoret e Kombit"- Rruga "Sami Frasheri")- Zona A
3. Rruga "Mihal Duri" (segmenti "Kavajes"- Rruga "Durrsit") -Zona A
4. Rruga "Bogdanëve" (segmenti "Kavajes"- Rruga "Mine Peza") -Zona A
5. Rruga "Dora Distria" (segmenti "Kristo Luarasi"- "Adem Jashari)- Zona B
6. Rruga "Kongresi Manastirit" (segmenti "Bardhyl"- Rruga "Imer Nregjoni") -Zona B
7. Rruga "Kosovarve" (segmenti " Kristo Luarasi "- Rruga " Liman Kaba") -Zona B
8. Bulevardi "Gjergj Fishta"(segmenti "Muhamet Gjollesha"- "Rruga e Kavajes"-Zona B

Më konkretisht:

Parkimi në rrugë, është një aspekt i rëndësishëm dhe shumë kritik për një qytet të urbanizuar si Tirana, veçanërisht për një qytet qendër të aktiviteteve sociale dhe ekonomike.

Zhvillimet demografike dhe ato social-ekonomike të qendrës më të madhe urbane dhe administrative të vendit-Tiranës- kanë nxjerr në pah nevojën për organizimin e parkimit dhe lehtësimin e lëvizjes sipas parimeve të mobilitetit (multimodal).

Parkimi në rrugët e sipërpërmendura u lejon klientëve të vizitojnë biznese dhe pjesë të tjera të qytetit, qytetarët marrin mjetin në pronësi dhe e planifikojnë shpërndarjen e tyre në aktivitetet sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, parkimi është i nevojshëm në një qytet për të inkurajuar trafikun dhe kënaqur banorët e tij me aktivitete tregëtare, sociale etj.


Megjithatë, parkimi është një çështje komplekse, e cila ka një impakt të drejtpërdrejtë mbi transportin urban dhe atë rajonal, mobilitetin, aksesin, zhvillimin, cilësinë e mjedisit dhe përdorimin e hapësirës urbane.

Politikat e parkimit, të lidhura me Masterplanin e Transportit në qytetin e Tiranës, mund të inkurajojnë komunitetin të shfrytëzojë ose jo automjetet në qytet, të rëndohet ose jo situata e rrugëve dhe të shtohet ose jo ndotja e ambjentit. Kjo politikë drejtohet në krijimin e zonave të administruara të parkimit ose zonave të shërbimit, në të cilën do të aplikohen nivele të regullimeve të ndryshme mbi një mekanizëm kontrolli/administrimi të përcaktuar. Vendosja nën kontroll/administrim do të përcaktohet sipas


kritereve, rregullave, kufizimeve dhe lejimeve për të krijuar përdorimin më të mirë të mundshëm të hapësirës/zonës së parkimit sipas përdoruesve, orareve, destinacionit dhe pozicionit, për të akomoduar edhe kërkesat e banimit, por edhe ato të aktiviteteve administrative dhe tregëtare, pra për të mbështetur zhvillimin ekonomik, por duke inkurajuar transportin multimodal dhe shmangur “konfliktet” me trafikun dhe lëvizjen.

Rrugët e propozuara për administrim nga Tirana Parking sipas segmentit të përcaktuar në hartën e Bashkisë Tiranë :


1. Rruga “Asim Zeneli” (segmenti Rruga “Papa Gjon Pali II”- Rruga “Elbasanit”)-
Zona A e tarifimit
Fig. 1




2. Rruga “Ismail Qemali” (segmenti Blv “Deshmoret e Kombit”- Rruga “Sami Frasheri”)- Zona
A e tarifimit
Fig. 2



3. Rruga "Mihal Duri" (segmenti Rruga "Kavajes"- Rruga "Durrësit")
 -Zona A e tarifimit
 Fig. 3




4. Rruga "Bogdanëve" (segmenti "Kavajes"- Rruga "Mine Peza")
 -Zona A e tarifimit
 Fig. 4



7. Rruga "Kosovarve" (segmenti Rruga " Kristo Luarasi "- Rruga " Liman Kaba)"
 -Zona B e tarifimit
 Fig. 7



8. Bulevardi "Gjergj Fishta"(segmenti "Muhamet Gjollësja"- "Rruga e Kavajës")
 -Zona B e tarifimit
 Fig. 8



Duke ju referuar disponibilitetit të hapësirave rrugore për vendparkime në qytetin e Tiranës, me qëllim administrimin e parkimit në këto rrugë, duhet të vendosen disa kritere për përcaktimin e vendeve të destinuara për parkimin dhe të krijohen zonat e parkimit të kontrolluar (me ose pa pagesë) për parkimin në rrugë.

Zonat e administrimit të parkimit (ZAP) dhe nënzonat e destinuara për parkim (NDP) në qytetin e Tiranës duhet të kenë disa specifikime dhe të dhënash si :

Në sistemin bazë të të dhënave përfshihen :

- a. emërtimi i rrugës
- b. gjatësia e aksit rrugor
- c. kategoria e rrugës (sipas përcaktimeve në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor")
- d. numri i vendparkimeve të mundura
- e. drejtimi lëvizjes krahu i lejuar i parkimit

Bazuar mbi studimet dhe mundësitë reale të komentuara më sipër, krijohen zonat e shërbimit, në të cilat parashikohen:

Parkimet me pagesë në rrugë

Ndarja në % e vendparkimeve publike me pagesë dhe vendparkimeve pa pagesë të lira.

Për llogaritjen e hapësirës që aktualisht është e disponueshme për parkimin (pra për të përcaktuar zonat e parkimit bazohemi në këto kritere) :

- a. hapësirat e nevojshme për kryqëzimet, duke konsideruar 5 m (minimalisht) nga fundi i parkimit deri në distancën e fillimit të korsisë dhe 30 m nga impiantet semaforike - këto hapësira janë të rëndësishme për gjithë trafikun dhe sigurinë e këmbësoreve rrugore;
- b. hapësirat e zëna nga koshat e mbeturinave në rrugë VGM;
- c. hapësirat e zëna nga zonat e ndalimit për shërbimet e transportit publik (stacionet e autobuzave) etj.

Zonat Tarifore me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre ndahen si më poshtë:

Zona A: Përfshin zonat më të nxehta ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet të lartë. Një pjesë të rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e Administrës Publike (qëndrore dhe lokale), qendrat e biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, lokalet dhe njësitë e shërbimit etj. Nga sondazhet e kryera, hapësirat e parkimit në rrugë shfrytëzohen maksimalisht, sidomos gjatë mesditës kur kërkesat janë më të mëdha se numri i vëndparkimeve disponibël.

Duke ju bazuar karakteristikave të zonës Tirana Parking propozon ti shtohen në Zonën A të tarifimit-4 (Kater) rrugë për administrim:

1. Rruga "Asim Zeneli" (segmenti "Papa Gjon Pali II"- Rruga "Elbasanit")
2. Rruga "Ismail Qemali" (segmenti Blv "Deshmoret e Kombit"- Rruga "Sami Frasheri")
3. Rruga "Mihal Duri" (segmenti "Kavajes"- Rruga "Durrsit")
4. Rruga "Bogdanëve" (segmenti "Kavajes"- Rruga "Mine Peza")

Duke ju bazuar disa kriterëve për të pasur një balancë midis kërkesës dhe ofertës për parkim është vendosur të implementohet parkimi i kontrolluar duke sjell në zgjidhjen e disa problemeve p.sh. mungesa e kapaciteteve të parkimit (në dhe jashtë-rrugës) në hapësirat e bizneseve në qytet, mund të vonojë rritjen ekonomike të qytetit, mund të krijojë stres tek shoferët të cilët kërkojnë parkim dhe mund të rezultojë në rritje të trafikut.

Zona B: Përfshin zonat ku mbizotërojnë shkëmbime tregtare, financiare, institucionale apo sociale me intensitet mesatar, ku qëndrimi i automjeteve në parkim zgjat normalisht 1-3 orë. Në këto zona kohëzgjatja e qëndrimit diktohet nga nevojat e klienteve, në bazë të standartit i jetesës së tyre dhe funksioneve të zonës. Një nga qëllimet e kontrollit/administrimit të parkimit në rrugë është vendosja e një kufiri, sa gjatë një drejtues mjetei mund të parkojë në një zonë të caktuar përkundrajt me drejtues të tjerë që duan të rinë më gjatë dhe që kërkon përdorimin e parkimeve jashtë atyre të përcaktuara në rrugë (parkimi aftashkurtër dhe afatgjatë, që përcaktohet nga kohëqëndrimi dhe rregullat e përcaktuara për kohëqëndrimin e lejuar).

Duke ju bazuar karakteristikave të zonës Tirana Parking propozon ti shtohen në Zonën B të tarifimit-4 (Kater) rrugë për administrim:

1. Rruga "Dora Distria" (segmenti "Kristo Luarasi"- "Adem Jashari")
2. Rruga "Kongresi Manastirit" (segmenti "Bardhyl"- Rruga "Imer Nregjoni")
3. Rruga "Kosovarve" (segmenti "Kristo Luarasi"- Rruga "Liman Kaba")
4. Bulevardi "Gjergj Fishta" (segmenti "Muhamet Gjollësja"- "Rruga e Kavajes")

Bazuar në pikën 7, aneksi Nr.2, i Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.49, datë 11.11.2015 për "Miratimin e Kriterëve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim"si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës ku citohet se :

Zona 1

Me kufij: vija kufizuese e qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Perëndimore, bulevardi "Zogu i Parë" në anën Lindore dhe kordoni hyrës me rrugët "Lazi Miho", "Konferenca e Pezës" duke vazhduar përgjatë bulevardit "Gjergj Fishta" në anën Jugore, deri në ndërprerjen me bulevardin "Dëshmorët e Kombit".

Zona 2

Me kufij: zona përgjatë bulevardit "Zogu i Parë" në pjesën Perëndimore, vija kufizuese e qytetit të Tiranës në pjesën Veri/Lindore dhe zgjatimi i bulevardit "Zhan D'Ark" deri në vijën kufizuese në anën Jugore.


Zona 3

Me kufij: segmenti i bulevardit “Dëshmorët e Kombit” në anën Perëndimore, bulevardi “Bajram Curri” dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijën kufizuese në anën veriore dhe vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në pjesën Jug/Lindore.

Zona 4

Me kufij: kordoni hyrës përgjatë rrugës “Konferenca e Pezës” në anën Veriore, bulevardi në vijën kufizuese të qytetit të Tiranës në anën Lindore, zona përgjatë segmentit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” në pjesën Lindore dhe vija kufizuese e Tiranës në pjesën Jugore të saj.


Nënzonat e Destinuara për Parkim në Rrugë (NDPRr) në Zonën e Administrimit të Parkimit nr.1 (ZAP – 1), Harta nr. 2



Pasqyra e ZAP Nr.1

Nr	EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME	PARKIM PA PAGESE
		PAGESE	(INVAIDE + LIRE)
		%	%
1	Rruga “Bogdanëve” (segmenti “Kavajes”- Rruga “Mina Peza”)	60	40
2	Rruga “Mihal Duri” (segmenti “Kavajes”- Rruga “Durrësit”)	70	30
3	Bulevardi “Gjergj Fishta”(segmenti “Muhamet Gjollësia”-“Rruga e Kavajes”)	70	30


Nënzonat e Destinuara për Parkim në Rrugë (NDPRr) në Zonën e Administrimit të Parkimit nr.2 (ZAP – 2), Harta nr. 3



Pasqyra e ZAP Nr.2

Nr	EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME	PARKIM PA PAGESE
		PAGESE	(INVALIDE + I LIRE)
		%	%
1	Rruga "Kongresi Manastirit" (segmenti "Bardhyl"- Rruga "Imer Nregjoni")	70	30


Nënzonat e Destinuara për Parkim në Rrugë (NDPRr) në Zonën e Administrimit të Parkimit nr.3 (ZAP – 3), Harta nr. 4



Pasqyra e ZAP Nr.3

Nr	EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME	PARKIM PA PAGESE
		PAGESE	(INVALIDE + LIRE)
		%	%
1	Rruga "Asim Zeneli" (segmenti "Papa Gjon Pali II" - Rruga "Elbasanit")	80	20

Nënzonat e Destinuara për Parkim në Rrugë (NDPRr) në Zonën e Administrimit të Parkimit nr.4 (ZAP – 4), Harta nr. 5




Pasqyra e ZAP Nr.4

Nr	EMRI RRUGES	PARKIM PUBLIK DHE I REZERVUAR ME	PARKIM PA PAGESE
		PAGESE	(INVAUDE+I LIRE)
		%	%
1	Rruga "Ismail Qemali" (segmenti Blv "Deshmoret e Kombit"- Rruga "Sami Frasher")	80	20
2	Rruga "Dora Distria" (segmenti "Kristo Luarasi"- "Adem Jashari")	60	40
3	Rruga "Kosovarve" (segmenti " Kristo Luarasi"- Rruga " Liman Kaba")	50	50

Bazuar në pikën 14 , aneksi Nr.2, i Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.49, datë 11.11.2015 për "Miratimin e Kriteve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim"si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës ku citohet se : *Drejtoria respektive në Bashki kur vlerëson se janë plotësuar kushtet për shtrirjen e sistemit të parkimit, propozon për miratim pranë Kryetarit plotësimin, përmirësimin ose shtimin e NDP me nënzonat respektive në mbështetje të kriteve të përcaktuara në kapitujt përkatës.Gjithashtu e njëjta procedurë ndiqet në rastin kur NDP me nënzonat respektive bien ndesh me projektet për zbatim të korsive të dedikuara të transportit publik dhe biçikletave, duke bërë rishikimin e NDP ose nënzonave sipas rastit.*

Për sa më sipër, me propozim të Kryetar të Bashkisë, i paraqesim Këshillit Bashkiak këtë kërkesë për shtimin e disa rrugëve të reja në zonën A dhe B për t'u administruar nga Tirana Parking .

Mexhit Doçi 
Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Enola Bejko 
Përgjegjëse e Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Enton Punavija
Drejtor i Transportit dhe Trafikut Rrugor


Laura Deliu
Drejtor, Drejtoria Juridike

Egla Zere
Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Parking


Taulant Tusha
Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike

Alban Dokushi
Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licencimit

Arbjan Mazniku
Nënkryetar



Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1743 / Prot.

Tiranë më 04.04.2018

Lënda: Verifikim Ligjshmërie

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Tiranë

Bazuar në Ligjin nr.107/2016, dt. 27.10.2016 « Per Prefektin e Qarkut», neni 8, gërma a, neni16, gërma 2/a, dhe Ligjin nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, « Për vetëqeverisjen Vendore », Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr. 20, dt. 21.03.2018, si dhe vendimeve nr. 21- 43 dt. 29.03.2018 të Këshillit Bashkiak Tiranë.

Pas verifikimit rezultoi se, vendimet nr. 20 dt. 21.03.2018 dhe 21,22,23,24, dt. 29.03.2018 janë marrë në përputhje me formën dhe procedurën e referencës ligjore të mësipërme, si dhe në përputhje me Ligjin nr.9355, dt.10.03.2005 « Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore », i ndryshuar.

Vendimet nr. 25 dhe 26 dt, dt. 29.03.2018 janë në përputhje me procedurën e referencës ligjore të mësipërme, si dhe me VKM nr. 753 dt. 13.12.2017 « Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike » si dhe me VKM nr. 903 dt. 21.12.2016 « Për caktimin e kriterëve dhe për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, etj » i ndryshuar.

Vendimet nr. 27 dhe 28, dt. 29.03.2018, janë në përputhje me procedurën e referencës ligjore të mësipërme, si dhe me Ligjin 9232, dt. 13.05.2004, « Për programet sociale » i ndryshuar si dhe me VKM nr. 814 dt. 03.12.2004 »Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit ».

Vendimet nr. 29, 30, 31, 32 dhe 33 dt. 29.03.2018, janë në përputhje me procedurën e referencës ligjore të mësipërme si dhe me Ligjin nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, « Për vetëqeverisjen Vendore ».

Vendimi nr. 34 dt. 29.03.2018, është në përputhje me VKM nr. 425 dt. 27.06.2012 « Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publike, të përkujdesjes shoqërore ».

Vendimet nr. 35 dhe 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, dt. 29.03.2018 janë në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, « Për vetëqeverisjen Vendore ».

Vendime të mësipërme janë në përputhje me ligjin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

SUZANA JAHOLLARI

